



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:227543
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05729749

Ac.nr.815/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj e Besnik Feka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.Sh, nga P,,, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.T avokat nga P,,, kundër të paditurës Këshilli Gjyqësor i Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë B.M dhe D.B, për shkak të kompensimit të demit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe ankesën e të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1797/17, të datës 21.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pathemelta ankesa e paditësit N.Sh nga P,,, dhe ankesa e të paditurës Republika e Kosovës - Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1797/17, i datës 21.11.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1797/17, të datës 21.11.2020, në pikën **I (një)** të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.Sh nga P,,, dhe e ka detyruar të paditurin Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që paditësit në emër të kompensimit të demit jo material, për shkak të qëndrimit në paraburgim 471 ditë, dhe në arrest shtëpiak 177 ditë, të ja paguaj shumat si në vijim: -Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit dhe lirive të ja paguaj shumën në vlerë prej 25.000 mije euro. - Në emër të frikës së përjetuar të ja paguaj shumën në vlerë prej 7.400 euro. Gjithsej shumën e përgjithshme prej 32.400, euro, me kamatë ligjore, në lartësi prej 8 %, duke llogaritur nga dita e

marrjes se aktgjykimit. Në pikën **II** (dy) të dispozitivit e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë, përtej shumës se gjykuar në pikën I. Dhe atë në emër të dhimbjeve shpirtërore humbjes se reputacionit, cenimit të integritetit, personal dhe familjar dhe frikës se përjetuar shumë prej 117.600 euro, dhe në tërësi kërkesa për kompensim në emër të sëmundjes se fituar gjatë qëndrimit në paraburgim në lartësi prej 40.000, euro, dhe atë në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm punës në shumë prej 25.000 euro si e pa bazuar. Në pikën **III** (tre) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit të ja kompensoj shpenzimet procedurale në shumë prej 1,795, euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e marrjes se aktgjykimit (12.11.2020), deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sa i përket lartësisë së kompensimit dhe llogaritjes së kamatës*, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ankesën e paditësit ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj sipas vërejtjeve të cekura dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tersi si të bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, edhe e paditura ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj, dhe lëndën ta kthej në rigjykim për vendosje meritorë, apo që të njëjtin ta ndryshoj dhe paditësit t'ia njoh të drejtën e kompensimit të dëmit jo material konform kritereve të përcaktuara në Udhëzimin administrativ 04/2015 të KGJK-së, për zbatimin e procedurës së kompensimit të dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa bazë.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së palës së paditur, ndërsa as e paditura nuk ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e paditësit është e pathemeltë.*
- *Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 19.07.2017, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi (të precizuar përmes parashtresës së datës 16.10.2020) për shkak të kompensimit të dëmit, kundër të paditurës, me arsye sikurse në padi dhe precizim.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.1797/17, të datës 21.11.2020, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë

e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit, ka theksuar se në mes të palëve ndergjyqjese nuk ishte kontestues fakti se paditësi padrejtësisht ishte privuar nga liria, dhe se padrejtësisht ishte ngarkuar me veprën penale krime lufte, po ashtu nuk ka qenë kontestues as fakti se paditësit i takon e drejta në kompensimin e demit, dhe se ajo është përgjegjësi e të paditurës pasi që në procedurë jashtë gjyqësore e paditura ka ofruar marrëveshjen për kompensimin e demit, mirëpo ka qene kontestuese fakti sa i përket lartësisë se kompensimit. Meqenëse paditësi ka qëndruar në paraburgim 471 ditë dhe 177 ditë në arrest shtëpiak (fakt i pa kontestuar), i'u kishte drejtuar me kërkesë të paditurit Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjegjësisht Komisionit për Kompensim dëmi personave të dënuar pa arsye dhe të privuar nga liria pa bazë, për kompensim dëmi material dhe jo material. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjegjësisht Komisionit për Kompensim dëmi personave të dënuar pa arsye dhe të privuar nga liria pa bazë, me paditësen kishin negociuar ujdj jashtëgjyqësore dhe i kishte ofruar marrëveshje për arritjen e ujdisë jashtëgjyqësore datë 26.05.2017, e cila ishte arritur vetëm për sa i përket demit material. Kurse nga kjo rezulton se paditësi nuk e ka pranuar ofertën e negociuar lidhur me dëmin jo material, prandaj ju ka drejtuar gjykatës me padi për kompensim dëmi jo material. Gjykata e shkallës së parë më qellim të vërtetimit e natyrës, llojit, intensitetit, pasojave të mbetura, friken e përjetuar gjatë kohës sa ka qëndruar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse ka bërë nxjerrjen e provës më ekspertizë psikiatrike të hartuar nga psikiatri Dr. Sh.H, ku edhe lidhur me kërkesën e palës paditëse për natyrën e lëndimeve, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar mendimit dhe konstatimit të ekspertit të dhënë në ekspertizën e hartuar më shkrim me datë 02.10.2020, si dhe sqarimet e dhëna lidhur për ekspertizën në seancën e shqyrtimit gjyqësor në prani të palave ndergjyqjese, ku në bazë të ekspertizës dhe sqarimeve shtese sipas psikiatrit është konstatuar se paditësi gjatë kohës sa ka qëndruar në paraburgim dhe në tërësi më akuzat, ka pas shqetësime psikike, në formë të ankthit, frikës, humbjes se shpresës, zemërimit, mërziisë, denigrimit, ndrojtjes, pritjes, pagjumësie, shqetësime tjera të stomakut, vegjentative, lodhje, djersitje, dhimbje koke, dhimbje trupi tej. Gjykata e shkallës së parë ekspertizën mjekësore të psikiatrisë, e ka pranuar në tërësi si të besueshme, dhe se e njëjta ishte profesionale dhe mire e argumentuar, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve në këtë çështje kontestimore. Andaj duke pas parasysh mendimin dhe konstatimin e ekspertit, në emër të dhimbjes shpirtërore të përjetuar për shkak të cenimit të autoritetit, nderit dhe lirisë, si dhe frikës se përjetuar gjatë kohës sa ka qenë i privuar nga liria gjykata e ka gjykuar në shumë të përgjithshme prej 32.400 euro. Gjykata e shkallës së parë pjesën tjetër të kërkesëpadisë e si në pikën II. Të dispozitivit, në emër të dhimbjet shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, dhe lirive, dhe frikës, në shumë prej 117.600 euro, e refuzoj ngase vlerësoi se një lartësi e kërkesës se tillë nuk është ekuivalente më përjetimet e paditësit sa i njëjti ka qëndruar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, dhe se çdo shumë e gjykuar më lartë se shumë e gjykuara në këtë aktgjykim nuk do të kishte për qellim satisfaksionin për paditësin por do të përbente përfitim pasuror, e ku ligji ka përcaktuar se qëllimi i kompensimit nuk është përfitimi pasuror, por satisfaksioni ka për qellim ta kompensoj të dëmtuarin për përjetimet e pësuar me rastin e privimit të lirisë pa arsye. Kërkesa për kompensim në emër të sëmundjes se fituar gjate qëndrimit në paraburgim në lartësi prej 40.000, euro, dhe atë në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm punës në shumë prej 25.000 euro, gjykata e shkallës së parë e refuzoj si të pa bazuar për faktin se paditësi nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë të vetme e cila do të vërtetonte

mjaftueshëm se paditësit një sëmundje e tillë i është shkaktuar si pasoje e kushteve të këqija në qendrën e paraburgimit, e të cilat kushte kanë pasur ndikim në gjendjen e tij shëndetësore, andaj gjykata e shkallës së parë nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe nga thëniet e të autorizuarit të paditësit nuk mundi ta vërtetoj shkaktarin e sëmundjes së tij. Po ashtu gjykata e shkallës së parë e refuzoj edhe kërkesën e paditësit për kompensim në vlerë prej 25.000 euro sa i përket, zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor si të pa bazuar për faktin se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë që do të dëshmonte se sa ka rënë aktiviteti i përgjithshëm punues i paditësit, këtë pjesë të refuzuar të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë e mbështetet në nenin 319 par 1. të Ligjit të Procedurës Kontestimore ku thuhet se “ *Secila nga palët ndergjyqese ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkesat* ” mbi bazën e kësaj gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se pala paditëse në këtë rast nuk ka arritur ti vërtetoj faktet e pretenduara, lidhur me këtë lloj të kompensimit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as shkelje të tjera të cilat palët ankuese i kanë pretenduar me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar.

Gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë sa i përket pasojave që ka pësuar paditësi për shkak të privimit pa të drejtë nga liria, përkatësisht për dëmin jo material për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës me të cilat ka kundërshtuar pjesërisht ekspertizën e ekspertës së psikiatrisë Dr. Sh.H të datës 02.10.2020, pasi që e paditura gjatë procedurës së zhvilluar në shkallën e parë nuk e ka kundërshtuar kualitetin profesional të ekspertizës dhe nga shkresat e lëndës nuk rezulton se e paditura ka propozuar plotësim apo ekspertizë tjetër. Si rrjedhojë, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur të paraqitura me ankesë se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë procedurë pasi që e njëjta drejtë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike edhe sa i përket pasojave që ka pësuar paditësi për shkak të privimit pa të drejtë nga liria. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese

dhe besueshmërinë e ekspertizës nga lëmia e psikiatrisë të punuar nga dr. Sh.H - psikiatër, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këtë kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në përputhje me natyrën e dëmit jo material të pësuar nga paditësi për shkak të vuajtjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, lirisë, të drejtave të personalitetit dhe frikës së përjetuar si pasojë e privimit të kundërligjshëm nga liria. Andaj edhe nga këto arsye kjo gjykatë e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, pasi aktgjykimi është i arsyetuar dhe paditësi ka të drejtë në kompensimin e dëmit jo material konform nenit 529 par.1, pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, neni 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, por edhe në harmoni me praktikën gjyqësore të gjykatave të Kosovës, përkatësisht tani edhe me Udhëzuesin për caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jomaterial të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.41/2023, të datës 27.02.2023.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të palës paditëse lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, në drejtimin e asaj që lartësia e shumës së gjykuar nga gjykata e shkallës së parë është e ulët, përkatësisht nuk e kompenson dëmin e pësuar dhe në asnjë rrethanë nuk e zbut pasojën dhe vuajtjet e përjetuara të paditësit, por edhe pretendimet ankimore të palës së paditur në drejtimin e asaj që shumica e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë është shumë e lartë. Lidhur me shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e Apelit vlerëson se e njëjta është reale dhe në përputhje me dhimbjet shpirtërore, shkeljen e prestigjit dhe të nderit të përjetuara nga ana e paditësit, si pasojë e mbajtjes paraburgim pa bazë ligjore në kohëzgjatje 471 ditësh dhe në arrest shtëpiak pa bazë ligjore në kohëzgjatje prej 177 ditësh. Kjo ngase me nenin 183 par.1 të LMD-së, parashihet se *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*. Ndërsa në pragrafin 2 të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërbën ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”* Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh natyrën e dëmit që paditësi ka pësuar si dhe shkallën e të mirës nga e cila ai është privuar dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarit - këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t'i riparojë në një masë dëmin e pësuar. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vendosur konform kësaj, duke vendosur shumica të mjaftueshme, që i përgjigjen shkallës së nevojës për kompensim për dëmin jo material të pësuar e që të njëjtin e ka konstatuar me anë të ekspertizës së lartcekur. Për më shumë kjo gjykatë vlerëson se edhe në nenin 5 par. 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave

dhe Lirive të Njeriut, i cili shprehimisht përcakton se *“Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim”*. Të njëjtën të drejtë për kompensim këtu paditësit ia njuhë edhe Protokolli 7 i Konventës së cekur më lartë, përkatësisht neni 3 i saj, i cili shprehimisht thotë: *“Kur një person është dënuar për një vepër penale me vendim të formës së prerë dhe kur ky dënim është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtazi që provon një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar ndëshkimin për arsye të këtij dënimi, zhëdëmtohet sipas ligjit ose praktikës në fuqi në Shtetin në fjalë...”*. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit i refuzon si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditësit dhe të paditurës lidhur për zbatim të gabuar të së drejtës materiale në rastin konkret, për çka edhe është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Për kamatën gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur në pajtim me dispozitat e nenit 382 të LMD, duke e gjykuar të njëjtën në lartësinë 8% e cila është llogaritur nga data 12.11.2020, e deri në pagesën definitive.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të palës ankuese, por ka gjetur se të njëjtat kanë qenë pa ndikim për ndonjë vendim tjetër nga sa u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të lartcekurave, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur në këtë çështje kontestimore, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2848/21, datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Arsim Hamzaj